



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**Lënda:** Dërgohet raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë 2021 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3**

**TIRANË**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- **Zbatimi i Ligjit nr. ligji 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” në disa drejtime:**
- ✓ Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
- ✓ Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- ✓ Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji 45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991.
- ✓ Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Autoriteti në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për çdo kërkesë të paraqitur nga:

1. Institucionet për:

- ✓ verifikimin e zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë;
- ✓ verifikimin e kandidatëve për funksione të zgjedhshme;
- ✓ verifikimin e propozimeve për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit.

2. Individët për:

- ✓ njohje në cilësinë e; - të prekurit; - palës së tretë; - bashkëpunëtoreve; - të favorizuarëve të Ish-Sigurimit të Shtetit.
- ✓ rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ dëmshtëpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ✓ qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve

3. Studiuesit dhe Media për qëllime:

- ✓ kërkimore;
- ✓ historike;
- ✓ edukimi.

ndjek procedurat si më poshtë:

***Për çdo kërkesë të paraqitur nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Media, Autoriteti:***

- ✚ Pararakisht shqyrton dhe trajton në mbledhje të Autoritetit, legjitimitetin e kërkesës së paraqitur, duke vendosur ndjekjen e procedurave në vijim dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës.
- ✚ Dërgon shkresat për vazhdimin e procedurës institucioneve përkatëse, për kontrollin dhe verifikimin e figurës së personave, sipas të dhënave të identitetit të tyre dhe në rast mungesë të dhënash, bën me dije shkresërit institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e të dhënave plotësuese sa më shpejt, me qëllim administrimin e dokumentacionit përkatës dhe vijimin e shqyrtimit të tij nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e verifikimit të figurës së shtetasit mbi bazën e objektit të kërkesës, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e deklasifikimit të dosjeve dhe bën bibliografinë e secilës (dosje formulare, dosje përpunimi, dokumente, fashikuj etj), në rastin kur dokumentacioni i administruar është i klasifikuar.
- ✚ Kryen përpunimin e dokumentacionit, para se ai t'i vihet në dispozicion kërkuarit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 45/2015.
- ✚ Kryen trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuari në mbledhje të Autoritetit, mbi bazën e rezultatit të verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.

### Treguesit për matjen e performancës janë:

- Numri në rritje të kërkesave nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Mediat të trajtuara nga ana e Autoritetit;
- Numrin i ankesave në raport me vendimet e marra nga ana e Autoritetit;

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për 4-mujorin e parë 2021, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave.

### Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare

Për 4-mujorin e parë 2021, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2021	Buxheti me ndryshimet Viti 2021	Realizimi faktik për 4-mujorin e parë 2021	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	107,176	107,176	23,961	20.1%

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2021, jepet në tabelën e mëposhtme:

*Në mijë lekë*

Llog	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2021	Buxheti me ndryshimet Viti 2021	Realizimi faktik Viti 2021	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	64,600	64,600	17,263	26.7%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	10,450	10,450	2,858	27.3%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	20,126	19,726	1,357	6.9%
606	Transferta per individet		400	50	12.5%
231	Kapitale të Trupëzuara	12,000	12,000	2,433	20.3%
	<b>T o t a l i</b>	<b>107,176</b>	<b>107,176</b>	<b>23,961</b>	<b>22.3%</b>

- **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore**, është realizuar respektivisht në vlerën **17 263 (në mijë) lekë** për paga si dhe **2 858 (në mijë) lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, ose 27 % të planit vjetor të këtij shpenzimi (600-601).
- Ndërkohë po vijohet me plotësimin e vendeve vakante sipas planit të rekrutimeve të miratuar në mbledhjen e Autoritetit.
- Është punuar për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Autoritetit (për periudhën janar-gusht), nëpërmjet trajnimeve të ASPA
- **Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime** (zëri 602 -606 ), për periudhën 4 –muajore 2021,

është realizuar për:

- Shpenzime për energji elektrike dhe ujë respektivisht 671 695 lekë dhe 165 180 lekë
- Pagesa për telefoninë celulare në vlerën 45 742 lekë.
- Pagesa për telefoninë fikse në vlerën 19 204 lekë.
- Janë likuiduar faturat për shërbimin e internetit sipas kontratës në vlerën 109 000 lekë.
- Shpenzime postare sipas kontratës së lidhur me postën shqiptare në vlerën 27 895 lekë.
- Shpenzime transporti për taksa, transport nga të tretët dhe siguracion të automjeteve në vlerën 21 648 lekë.
- Shpenzime për honorare ku perfshihen pagëesat e pedagogëve që marrin pjesë në komisionet e rekrutimit të punonjësve të rinju në vlerën 37 000 lekë.
- Shpenzimet kapitale në vlerën 516 160 lekë ku janë blerë pajisje kompjuterike dhe mobilje zyre

**Fondi për shpenzime investime (zëri 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve është 11.000 (në mijë) lekë. Realizuar në vlerën 2 432 (në mijë) lekë, ku fondi prej 450 (në mijë) lekë janë blerë pajisje zyre dhe 1 983 (në mijë) lekë është paguar tatimi mbi vlerën e shtuar për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së )dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne” pjesë e financimit të huaj nga Ambasada Suedeze.

Gjithashtu, është ndjekur në vijimësi **realizimi i financimit të huaj** (Kap 2) nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së )dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne”, treguesit e së cilës janë sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Llogaria</b>	<b>Në Lek</b>
600	865,971.00
601	396,351.00
602	4,400.00
231	14,883,544.00
<b>TOTALI</b>	<b>16,150,266.00</b>

Autoriteti ka nënshkruar një marrëveshje me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin: "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë kalimtare dhe pajtuese: zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste" i cili ka financuar në vlerën **4 919 (në mijë) lekë** (Kap 6) nga të cilat është realizuar në vlerën **362 (në mijë) lekë** për paga dhe kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore. Ky projekt sipas marrëveshjes do zgjasi për një periudhë 2 vjeçare.

**Të ardhurat nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave**

Për periudhën e raportuar, Autoriteti arkëtoi të ardhura nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave për riprodhimin e informacionit dhe dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në vlerën 145 320 lekë. Të ardhurat derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

**Krahasimi i të dhënave faktike ndërmjet Autoritetit dhe Thesarit**

*Në mijë lekë*

N r	Emertimi i programit	Shpenzimet korente		Shpenzim et kapitale	Thesar i Autoriteti	Totali		Diferenca
		Autoriteti	Thesari	Autoriteti		Thesar i		
1	Planifikim - menaxhim - administrim	21 529	21 529	2 432	2 432	23,961	23,961	0

**Në Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) nga kryerja e aktiviteteve, në zbatim të objektivave për vitin 2020.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në procesin e përmirësimit e përpunimit të mëtejshëm si dhe sqarimit e ndihmës në lidhje me formularët e kërkesave për informim nga Individët. Në vazhdimësi është mbajtur parasysh dhe ndërtuar punë konkrete për mbajtjen në nivele të larta dhe përmirësimin e formularit për kërkesat individuale për informim (online dhe paper).

**Për periudhën 4 mujore 1 Janar – 30 Prill 2021**, rezulton se:

- Në total janë paraqitur për legjitimim 82 kërkesa të reja;
- Mbyllje procedure janë 106 kërkesa nga të cilat:
  - i) Me dokumentacion arkivor janë 46 kërkesa

- ii) Pa dokumentacion arkivor janë 44 kërkesa.
- iii) Zbardhje bashkëpunëtorësh janë 8 kërkesë

**Në përfundim të këtij katër mujori Janar- Prill 2021 janë dorezuar qytetarëve 121 kërkesa me vendimet dhe fletë të anonimizuara dhe të digjitalizuara.**

Gjatë periudhës 4 mujore, nga ana e Sektorit të Kërkesave Individuale, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, si dhe të Rregullores së AIDSSH, me qëllim ruajtjen e të dhënave personale, të palëve të treta, të dhënave që kanë të bëjnë me mos cenimin e sigurisë kombëtare është bërë përpunimi i më shumë se 15.123 faqe nga të cilat 4.100 faqe janë të anonimizuara.

Kemi filluar aplikimin e skedës shoqëruese të dosjes (paper), me qëllim që gjatë përpunimit të dosjeve, në funksion të lehtësimit të kërkimit dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve me të dhëna, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, shkurtimin e afateve për njohjen dhe vënien në dispozicion të kërkuesve.

Në vlerësimin tonë dhe perceptimin publik të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”, qëllimi determinant dhe detyra prioritare e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë është dhe për një kohë të gjatë do të mbetet marrja në shqyrtim e kërkesave të paraqitura nga individët.

Në total për periudhën janar –prill 2021 nga Autoriteti janë marrë 55 vendime dhe janë verifikuar 220 kandidatë, kërkesa të reja institucionale janë 71 kërkesa, numri i kandidatëve për verifikim janë 239 kandidatë, janë verifikuar = 220 kandidatë

Gjatë vitit 2021 është hapur dhe kemi filluar procesin me një praktikë të re pune, e pa parashikuar në ligjin tonë organik, mbi pajisjen me vërtetime për efekte pensioni, për ish të përndjekurit politik. Nga muaji shkurt e në vijim janë zhvilluar diskutime dhe përgatitur disa variante për akte nga të cilat, u krijua procedura se si do operohet me këto kërkesa.

Mbështetja shkencore bazohet kryesisht në përpunimin e kërkesave individuale të studiuesve dhe medias për qëllime studimore dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor të kërkuar. Ky proces është kompleks sa u takon kërkesave studimore, kur për një kërkesë janë vënë në dispozicion nga 1 deri në 400 dosje, për rrjedhojë merr kohën e vet, që nga kërkimi në arkiv, identifikimi i dosjeve, digjitalizimi, anonimizimi, kontakti me familjarët dhe vënia në dispozicion studiuesve.

Për realizimin e objektivave të këtij sektori është punuar intensivisht dhe janë kryer detyrat si më poshtë:

- Janë legjitimuar 35 kërkesa janë paraqitur pranë DMSHEQ;
- Është përgatitur material për 12 mbledhje të Autoritetit;
- Janë përgatitur dhe dërguar Drejtorisë së Arkivit rreth 35 shkresa;

- Janë hartuar 40 vendime të cilat në vijim janë miratuar nga Autoriteti. Nga këto vendime, 36 kërkesa janë miratuar për vënie në dispozicion të dokumenteve, ndërsa për 4 kërkesa është marrë vendim për mbyllje praktike;
- Nga ky sektor, janë anonimizuar 40 vendime të DMSHEQ-së për publikim në rrjetet sociale të AIDSSH;

### **Sfida për të ardhmen:**

- a. Standard sa më të lartë informacioni, që do të thotë, së pari gjithshka që kërkohet sipas objektit të kërkesës dhe së dyti dhënia e informacionit për gjithshka të lidhur me objektin e ligjit 45/2015,
- b. Përgatitjen cilësore të materialeve informuese mbi dokumente të ish-sigurimit të Shtetit dhe vënien e tyre në dispozicion organizatorëve, në funksion të konferencave, takimeve, ëorkshopeve, programeve trajnuese, me qëllim krijimin e një kulture gjithpërfshirëse, për njohje me dokumentacionin arkivor, të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit,
- c. Gjetjen e mënyrave dhe mjeteve më efikase për të shpërndarë informacion, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit të qytetarëve dhe rinisë në vecanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që ju përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshëm të diktaturës komunisti, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të mara autentikisht nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.
- d. Bashkëpunimin me median, të cilën e shikojmë si promotor për të gjitha grupet e interesit, vecanërisht për studiuesit, duke e kthyer këtë institucion në një bibliotekë të hapur lehtësisht të aksesueshme, për të gjithë ata që u takon me ligj, ashtu siç është emërtuar edhe vetë ky institucion.

Realizimi i buxhetit për vitin 2021 u monitorua me përgjegjesi dhe u kërkua angazhimi i të gjitha strukturave të AIDSSH-së me qëllim realizimin me efektivitet të fondeve të planifikuara për vitin 2021.

Materiali është i publikuar në faqjen zyrtare të AIDSSH-së : [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)